

VENDIM
Nr. 164, datë 28.12.2015
PËR NDRYSHIMIN E VENDIMIT
NR. 143, DATË 26.11.2015, TË BORDIT TË ERE-s

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa “d”; 110, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenit 128 të Kodit të Procedurave Administrative, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2015, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për ndryshimin e vendimit nr. 143, datë 26.11.2015, të Bordit të ERE-s,

konstatoi se:

- Shoqëria “C & S Energy” sh.p.k., është licencuar në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, me vendimin nr. 143, datë 26.11.2015, të Bordit të ERE-s.

- Me vendimin nr. 143, datë 26.11.2015, është vendosur kushti që subjekti i licencuar të paraqesë në ERE menjëherë sapo të marrë vërtetimin përfundimtar të likuidimit të tatim-taksave.

- Shoqëria “C & S Energy” sh.p.k., ka depozituar në ERE vërtetimin përfundimtar të likuidimit të tatim-taksave.

- Në pikën 2, të vendimin nr. 143, datë 26.11.2015, është parashikuar se me plotësimin e kushtit, ky vendim është subjekt rishikimi nga ERE.

- Neni 128 i Kodit të Procedurave Administrative i jep të drejtën organit të administratës, të ndryshojë/të zëvendësojë aktet administrative.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

Të ndryshojë pikat 1 dhe 2, të vendimit nr. 143, datë 26.11.2015, të Bordit të ERE-s, si më poshtë:

1. Të licencojë shoqërinë “C & S Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

2. Licenca e tregtimit të energjisë elektrike e shoqërisë “C & S Energy” sh.p.k., i shtrin efektet e saj duke filluar nga momenti i hyrjes në fuqi të vendimit nr. 143, datë 26.11.2015.

3. Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmet